



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2021:179225

Datë: 05.10.2022

Numri i dokumentit: 03491815

C.nr.1003/2021

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI, si kontestimore e përbërë nga gjyqtari Naim Rekaliu, dhe bashkëpunëtori profesional Besart Prishtina, ne çështjen juridike te paditëses Z. K. nga fshati D. Komuna e V., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson A.P.-Sh., nga Vushtrria, kundër te paditurës K. e V.-D. K. e A. në V., te cilën me autorizim e përfaqëson Av. Ekrem Salihu, për shkak të anulimit të konkursit nr. 17003/21, të datës 19.04.2021, pas mbajtjes se seancës kryesore me datë 29.09.2022, jashtë seancës, gjykata me datë 05.10.2022, nxjerre këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET kërkesëpadia e paditëses Z.K. nga V.

II.ANULOHET PJESËRISHT SI I KUNDËRLIGJSHËM konkursi i shpallur nga e paditura K. e V.-D. K. e A. në V., me numër 17003/21 i datës 19.04.2021, për plotësimin e vendeve të lira të punës në Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria e Arsimit, vetëm për Shkollën Fillore “N. F.” Vushtrri, për një pozitë, me titull të vendit të punës Drejtor i Shkollës Fillore.

III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta te procedurës.

A r s y e t i m

Pretendime te palëve;

Paditësja me datë 13.08.2021 ka paraqitur padi nëpërmjet të autorizuarës së saj A. P.-Sh. kundër të paditurës K. e V.-D. K. e A. në V., me të cilën ka kërkuar anulimin e konkursit me numër 17003/21 të datës 19.04.2021, lidhur me vendin e punës në pozitën Drejtor, në Shkollën Fillore “N. F.” në V. të shpallur nga e paditura.

E paditura K. e V. nëpërmjet të autorizuarit të saj av. Ekrem Salihu, me datë 03.06.2022 ka paraqitur përgjigje në padi, nëpërmjet të cilës i konteston pretendimet e të paditës, se e përzgjedhura nga lista përfundimtare nuk i ka plotësuar kriteret e parapara me konkurs dhe atë pikën 1 dhe 2 të konkursit sepse paditësi nuk përmend fare pikën 3 dhe 4, ku në pikën 4 parashihet se edhe kandidatët me kualifikim 4 vjeçar (240 ECTS) dhe përvojë punë 4 vjeçare mund të aplikojnë dhe përzgjidhen drejtor shkolle. Po ashtu e padituri thekson se pretendimi i paditëses se komisioni vlerësues është formuar në kundërshtim me UA-151/2020 është i pabazuar. Në fund i ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj në tërësi si të pabazuar.

Paditësja, me datën 08.08.2022 ka bërë precizimin e padisë, ashtu që, gjykatës, i ka dorëzuar shkresa shtesë, lidhur me konkursin, emërimin e komisionit përzgjedhës, formularët, dosjen e paditëses dhe njoftimin nga komisioni lidhur me përzgjedhjen përfundimtare të kandidatit.

Pretendimet e palëve;

Gjykata, lidhur me padinë e paditëses, ka caktuar seancë kryesore me datë 29.09.2022, në të cilën kanë prezantuar të autorizuarit e palëve.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare e autorizuar e paditëses A.P.-Sh. ka deklaruar se, mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, duke shtuar se kandidatja e pranuar si drejtor shkolle nuk i ka plotësuar kriteret e konkursit gjegjësisht pikën 1 dhe 2 të njëjtit por edhe nenin 5 të UA-151/2020 për faktin e kandidati do të duhej të kishte të kryer programin universitar master për udhëheqje, administrim, apo menaxhim në arsim, ndërsa kandidatja e pranuar nuk ka të përfunduar program e sipër cekur universitar të nivelit Master. Tutje, ka shtuar se edhe komisioni përzgjedhës është formuar në kundërshtim me nenin 6 par.9 të UA-151/2020, në të cilin parashihet se komisioni përzgjedhës caktohet ad-hoc për një konkurs ose caktohet nga Kuvendi Komunal për një vit shkollor, ndërsa pika 3 e vendimit të Komunës së Vushtrrisë, të datës 27.05.2021 ka paraparë kohëzgjatjen e komisionit përzgjedhës deri në përfundimin e mandatit të Komunës së Vushtrrisë, ku në fund i ka propozuar gjykatës që padinë

dhe kërkesëpadinë e paditëses ta aprovoj si të bazuar dhe ta anuloj konkursin për pozitën e drejtor, në Shkollën Fillore “N. F.” V.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare i autorizuari i të paditurës av. Ekrem Salihu, ka deklaruar se, mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padi të datës 03.06.2022 dhe se padinë e paditëses e konsiderojnë në tërësi si të pabazuar. Nuk qëndron pretendimi i paditëses se kandidatja e pranuar nuk ka plotësuar kriteret sipas konkursit dhe UA-151/2020 lidhur me kualifikimin lidhur me arsimin universitar, pasi që sipas konkursit, përveç kandidatëve me nivel arsimit me master, konkursi dhe UA-151/2020 nuk përjashton kandidatët me shkollim universitar 4 vjeçar dhe me përvojë pune 4 vite, të cilat kriteret edhe i plotësuar kandidatja e përzgjedhur, pra mjafton plotësimi i njërit nga kushtet sa i përket shkollimit. Tutje ka shtuar se konform nenit 24 par.4 të Ligjit për Zyrtarët Publik të datës 11.03.2019, Gjykata Themelore Mitrovicë – Dega Vushtrri nuk është kompetente për vendosje sipas kësaj lënde dhe se paditësja është dashur të filloj konfliktin administrativ pranë gjykatës kompetente.

Shpenzimet e procedurës, nuk i ka kërkuar.

Provat e administruara:

Për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe fakteve vendimtare, gjykata gjatë shqyrtimit kryesor, i ka administruar provat dhe atë; *Konkursi me numër 17003/21 i datës 19.04.2021; Ankesa e paditëses për Komisionin e ankesave të Shërbyesve Civil në Komunën e Vushtrrisë; Njoftimi për rezultatet përfundimtare, i datës 09.07.2021; Formula B1 për paditësin Z. K., i datës 01.07.2021; Vendimi të paditurës me numër 37837/2021, i datës 30.07.2021, Përgjigja në padi e të paditurës; Formulari B1 për Valbona Drejta, i datës 23.06.2021; Formula B2, i datës 01.07.2021; Formularët për vëzhguesit e procesit; Vendimi i të paditurës për emërimin e komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në Komuna e Vushtrrisë, me numër 126/21, i datës 26.05.2021; Formulari C, për V. D., i datës 01.07.2021; Formulari C, i datës 01.07.2021; Formula C, për paditësen Z. K., i datës 01.07.2021; Formulari C për V. D.; Vendimi për rezultatet përfundimtare i të paditurës, i datës 09.07.2021; Formulari C për paditësen Z. K., i datës 01.07.2021; Formulari C, i datës 01.07.2021; Vendimi i të paditurës me numër 780/21, i datës 12.07.2021; Formulari i aplikimit për punësim i paditëses Z. K., i datës 24.05.2021; Certifikata për paditësen, e datës 18.12.2018; Certifikatë trajnimi për paditësen, e lëshuar nga USAID, në Shtator 2013; Certifikatë për paditësen e lëshuar në Qershor 2018; Certifikatë për paditësen e lëshuar nga USAID, në Qershor 2015; Formulari i modelit të*

deklarimit nën betim për paditësen Z. K.; Certifikata nga evidenca penale e personave kundër të cilëve është duke u zhvilluar procedurë penale dhe e personave të dënuar nga gjykata, e datës 11.06.2021; Certifikatë e lëshuar nga USAID në Mars 2013; Dosja e aktiviteteve të paditëses; Diplomë për paditësen-Master i Edukimit-Udhëheqje në Arsim, e datës 26.05.2016; Diplomë universitare, e datës 05.10.2015; Certifikatë shëndetësore, e datës 11.06.2021; Ekstrakt nga Regjistri Qendror i Gjendjes civile për paditësen; Certifikatë nga USAID, e datës Qershor 2014; Letër reference për paditësen, e datës 11.11.2020; Plani Zhvillimor i Shkollës; Plani zhvillimor, shkurt 2014 dhe mars 2020; Diplomë universitare për Valbona Drejta, e datës 04.11.2019; Dosja e konkursi 1 dhe 2; Certifikatë për Valbona Drejta, për udhëheqje arsimore, korrik 2005; Formular i aplikimit për punësim për Valbona Drejta, i datës 02.06.2021; Diplomë e kualifikimit universitar për Valbona Drejta, e datës 12.01.2010; Certifikatë nga USAID për Valbona Drejta, shkurt 2014; Vlerësimi i pjesëmarrësve për programin për zhvillim nga USAID për Valbona Drejta; Certifikatë shëndetësore e datës 26.05.2021, për Valbona Drejta; Certifikatë për të kaluarën kriminale, e datës 19.05.2021; Vërtetim i lëshuar nga Shkolla Fillore “N. F.” për Valbona Drejta, i datës 31.05.2021; Vërtetim i lëshuar nga e paditura, me numër 1023/20; Formular i deklaratës nën betim, i Valbona Drejta, i datës 31.05.2021; Letër reference për V. D., e datës 17.11.2020; Letër reference për Valbona Drejta, e datës 19.11.2020; Përmbajtja e portofolisë personale; Foto 1 dhe 2; Projekti i lëshuar gjatë mandatit; CV e Valbona Drejta; Certifikatë për Valbona Drejta, e lëshuar nga Ministria e Arsimit, e datës 25.05.2015; Certifikatë e lëshuar nga USAID, e datës 15.11.2012; Ekstrakt nga Regjistri Qendror për V. D.; Certifikatë për pjesëmarrje në trajnim për V. D., e datës 25.11.2020; Certifikatë për V. D.; Certifikatë për V. D., për vijueshmëri të rregullt të seminareve të programit “mësimdhënie me nxënësit në qendër”; Certifikatë e lëshuar nga Qendra për Arsim e Kosovës, për V. D., e lëshuar më datës 15.11.2005; Certifikatë për drejtor, e lëshuar me 27-29.05.2010, për V. D.; Certifikatë e lëshuar nga USAID; Licencë e mësimdhënësit e lëshuar nga Ministria e Arsimit, e datës 16.12.2019 dhe Plani zhvillimor i shkollës, i punuar me datë 28.11.2021.

Gjendja faktike:

Nga konkursi për plotësimin e vendeve të lira të punës, me numër 1700321, i datës 19.04.2021, gjykata ka konstatuar faktin se e paditura komuna e Vushtrisë, ka hapur konkursin për plotësimin e vendeve të lira të punës për pozitën drejtor, dhe atë për një pozitë në Shkollën Fillore “N. F.” dhe në Shkollën Fillore “M.V.”, pozitë jo e karrierës, me koeficient – 7.8, orët e punës 40, kohëzgjatja e emërimit 4 vite dhe kohëzgjatja e punës provuese gjashtë (6) muaj. Në këtë konkurs, janë përcaktuar edhe detyrat kryesore të punës, ndërsa konkursi është hapur duke u

bazuar në bazë të Ligjit për Zyrtarët Publik Nr.06/L-114, Kapitulli V, nenit 67 dhe 68 dhe Udhëzimit Administrativ nr.151/2020 për detyrat, përgjegjësitë, procedurat dhe kriteret e zgjedhjes së drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucionit publik edukativo arsimor dhe aftësues parauniversitar, dhe nenit 41, paragrafi 2 shkronja (ç) të statutit të Komunës.

Në konkursin e sipër cekur janë përcaktuar edhe kriteret lidhur me kualifikimet shkollore që duhet ti kenë kandidatët, ku janë paraparë kualifikimet si në vijim: 1. Master për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim (kualifikimi prej 300 ECTS, së paku 5 vite të shkollimit universitar); 2. Master arsimor (kualifikimi prej 300 ECTS, së paku 5 vite të shkollimit universitar); 3. Katërvjeçar (kualifikimi prej 240 ECTS, së paku 4 vite të shkollimit universitar); 4. Bachelor katërvjeçar (kualifikimi prej 240 ECTS, së paku 4 vite të shkollimit universitar).

Me datën 27.05.2021 është marr vendimi 128/21, për emërimin e komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në komunën e V., në Shkollën Filllore “M. V.” dhe Shkollën Filllore “N. Fr.” në V. ku, ndër të tjera, në pikën 3 është paraparë “Komisioni i cekur si në nenin 1 të këtij vendimi ka mandat deri në përfundimin e mandatit të Kuvendit”, ndërsa në pikën 4 është paraparë “Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë “ I njëjti është publikuar në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë – Vendimet e Kuvendit, me datën 29.07.2021, në linkun: <https://kk.rks.gov.net/vushtrri/category/shpalljet/vendimet/?page=1>.

Gjykata ka konstatuar se Formulari B/1 ka të bëjë me vlerësimin e dëshmimeve të prezentuara nga kandidatët për drejtor/zëvendës drejtor të IEAAP, në të cilin formular bëhet vlerësimi i secilit kandidat në raport me dëshmitë sa i përket “Shkallës së kualifikimit; Notës mesatare të studimeve katërvjeçare; Notës Mesatare të Studimeve Master; Njohjes së gjuhës/ve të huaja; Trajner në programe të trajnimit; Kontributit në proceset e zhvillimit të arsimit dhe Përvojën e punës në pozita udhëheqëse në sektorin e arsimit” ku janë paraparë gjithsej 20 pikë të mundshme, varësisht nga dëshmitë e prezentuara.

Nga njoftimi i të paditurës për rezultatet përfundimtare, gjykata ka konstatuar se komisioni për përzgjedhjen e kandidatëve, me datën 09.07.2021 ka shpallur rezultatet përfundimtare për pozitën drejtor, në Shkollën Filllore “N. F.”, në të cilat shihet se paditësja është ranguar e dyta në listë me 64.3 pikë të grumbulluara.

Paditësja e pakënaqur me rezultatet përfundimtare, me datën 16.07.2021 ka paraqitur ankesë pranë Komisionit për Zgjidhjen e Ankesave në DKA. Komisioni për Zgjidhjen e Ankesave me 37837/21 të datës 30.07.2021 ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditëses.

Baza ligjore:

Neni 2 par. 2 i Ligjit për Zyrtarët Publik, përcakton se zyrtarë publik janë, “1 nëpunësi i Shërbimit Civil (në tekstin në vijim: nëpunësi civil); 2. nëpunësi i Shërbimit Publik; 3. nëpunësi i Kabinetit; dhe 4. nëpunësi administrativ dhe mbështetës”, ndërsa paragrafi 4 i të njëjtit nen përcakton se “Nëpunës i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike”.

Neni 67 par. 1 i Ligjit për Zyrtarët Publik, përcakton se “Themelimi i marrëdhënies së punës për një nëpunës të Shërbimit Publik bëhet vetëm në bazë të një konkursi publik dhe të hapur, të organizuar sipas këtij ligji”.

Neni 68 par. 1 Ligjit për Zyrtarët Publik, përcakton se “Hapja e procedurës së konkurrimit shpallet nga NJBNJ, në ueb faqen e konkurremeve të SIMBNJ, të paktën 30 ditë para datës së planifikuar për paraqitjen e aplikimit nga kandidatët e interesuar”.

Neni 8 par. 1 i Ligjit të Punës nr 03/L-212, përcakton se “Punëdhënësi në sektorin publik, është i obliguar që të shpall konkurs publik sa herë që pranon një punëmarrës dhe themelon një marrëdhënie të punës”.

Neni 1 i Udhëzimit Administrativ nr. 151/2020 për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Drejtorit dhe të Zëvendësdrejtorit të Institucionit Publik Edukativo-Arsimor dhe Aftësues Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Procedurat e Zgjedhjes dhe Emërimit, Përfundimit të Kontratës dhe Emërimit të Përkohshëm, përcakton se “Detyrat dhe Përgjegjësitë e Drejtorit dhe të Zëvendësdrejtorit të Institucionit Publik Edukativo-Arsimor dhe Aftësues Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Procedurat e Zgjedhjes dhe Emërimit, Përfundimit të Kontratës dhe Emërimit të Përkohshëm”.

Neni 6 par. 9 i Udhëzimit të lartcekur Administrativ, përcakton se “Komisioni përzgjedhës caktohet për një konkurs. Për institucionet arsimore që janë në varësi të komunës, me propozim të DKA-së anëtarët e komisionit nga DKA mund të caktohen nga Kuvendi Komunal për një vit shkollor.”

Vlerësimi përfundimtar i gjykatës:

Nga gjendja e faktike e konstatuar më lartë. gjykata, gjeti se:

Nuk është kontestuese se Komuna e Vushtrisë – Drejtoria e Arsimit me datën 19.04.2021 kishte shpallur konkursin me nr.17003/21.

Nuk është kontestuese se janë zhvilluar procedurat e rekrutimit dhe se me datën 09.07.2021 ka shpallur njoftimin për rezultatet përfundimtare, në të cilat paditësja është ranguar e dyta në listë.

Sipas gjykatës, kontestuese në këtë çështje ishte ligjshmëria e komisionit përzgjedhës i emëruar me vendimin e Kuvendit Komunal të Vushtrisë, nr. 128/21, të datën 27.05.2021.

Gjykata pas administrimit të provave, pretendimeve të palëve, dhe bazës ligjore të lartcekur ka ardhur në përfundim se padia e paditëses duhet në aprovet si e bazuar për këto arsye:

Vendimi i Kuvendit Komunal me nr. 128/21 i datës 27.05.2021 është marr në kundërshtim me nenin 6 par.9 të Udhëzimit Administrativ 151/2020 për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Drejtorit dhe të Zëvendës Drejtorit të Institucionit Publik Edukativo-Arsimor dhe Aftësues Para universitar në Republikën e Kosovës, Procedurat e Zgjedhjes dhe Emërimit, Përfundimit të Kontratës dhe Emërimit të Përkohshëm, pasi që në të njëjtin, ashtu siç është cekur më lart, parashihet, se komisioni përzgjedhës caktohet për një konkurs, ndërsa për institucionet arsimore që janë në varësi të komunës, me propozim të DKA-së, anëtarët nga DKA, mund të caktohen nga Kuvendi Komunal për një vit shkollor, ndërsa në pikën 3 të vendimit për emërimin e komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në komunën e Vushtrisë është përcaktuar mandati i komisionit deri në përfundimin e mandatit të kuvendit, në kundërshtim të plotë me dispozitat e lartcekura, kur kihet parasysh se mandati i rregullt i Kuvendit Komunal është 4 vite, dhe lidhja e mandatit të komisionit me atë të Kuvendit Komunal nuk ka bazë ligjore dhe për këtë arsye ky vendim i Kuvendit Komunal të Komunës së Vushtrisë është i kundërligjshëm dhe rrjedhimisht edhe komisioni përzgjedhës i emëruar përmes atij vendimi.

Për më tepër, nga shkresat e lëndës shihet se vendimi nr. 128/21 i datës 27.05.2021 është miratuar në Kuvendin Komunal të Vushtrrisë me datën 27.05.2021, dhe në pikën 5 është paraparë se i njëjti hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë, ndërsa në faqen e zyrtare të Komunës së Vushtrrisë (<https://kk.rks.gov.net/vushtrri/category/shpalljet/vendimet/?page=2021>), mund të shihet se vendimi në fjalë është publikuar me datën 29.07.2021, nën emrin e dokumentit “*Vendimet e kuvendit të muajit maj 2021*” që nënkupton se i njëjti ka filluar të prodhoj fuqi ligjore nga data 05.08.2021 ndërsa e tërë procedura e konkursit (me publikimin e rezultateve përfundimtare) ka përfunduar me datën 09.07.2021. Nisur nga fakt, del se e tërë procedura e rekrutimit është zhvilluar pa ekzistuar një komision përzgjedhës, pasi që, gjatë kohës së shqyrtimit të dokumentacionit, intervistimin e deri te publikimi i rezultateve përfundimtare vendimi nr. 128/21 i datës 27.05.2021 i Kuvendit Komuna nuk ka pas fuqi ligjore, pasi që nuk ka kaluar koha e nevojshme (7 ditore) nga miratimi-publikimi e deri te hyrja në fuqi e vendimit, gjë që e bënë gjithë procedurën e rekrutimit të kundërligjshme.

Po ashtu, me rastin e shqyrtimit të dokumentacionit lidhur me kualifikimet e kandidatëve në raport me formularët e vlerësimit, gjykata, ka vërejtur shkelje në vlerësim, dhe atë nga Formulari B/1 për kandidaten Valbona Drejta, pika 2 e formularit që ka të bëjë me “Nota mesatare e studimeve katërvjeçare”, vërehet se e njëjta është vlerësuar me një (1) pikë, vlerësim ky që është ekuivalent me notën mesatare të arritur gjatë studimeve katërvjeçare prej 7.50 deri 8.49, ndërsa nga provat në shkresat e vërehet se kandidatja V. D., në diplomën e datës 11.01.2010 me numër 1502 ka notën mesatare 7.30, dhe në diplomën e datës 04.11.2019 me numër 214 ka notën mesatare 7.29, e që sipas Formularit B/1, kandidatja V. D. në pikën 2 të po të njëjtit është dashur të vlerësohet me 0.5 pikë, me të cilat vlerësohet një kandidatë që ka notë mesatare gjatë studimeve katërvjeçare ndërmjet 6 deri 7.49, pra, kandidatja V. D., është vlerësuar me 0.5 pikë më shumë sesa parashihet me Formularin B/1 për një kandidatë me notë mesatare 7.30 dhe 7.29 gjatë studimeve katërvjeçare.

Tutje, në pikën 4 të Formularit B/1 “*Dëshmi të njohjes së gjuhës/ve të huaja*” për kandidaten Valbona Drejta, gjykata ka vërejtur se e njëjta është vlerësuar me një (1) pikë, vlerësim ky që është i paraparë për kandidatët që kanë “a) *Gjuhë e huaj e mbrojtur në studimet universitare katërvjeçare/bachelor katërvjeçar apo studime master* dhe b) *Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar, niveli BI*”, ndërsa, në shkresat e lëndës nuk ka prova se kandidatja V. D. ka

“Gjuhë të huaj të mbrojtur në studimet universitare katërvjeçare/bachelor apo edhe master” dhe nuk ka prova se e njëjta ka “Gjuhë të huaj të mbrojtur me testim ndërkombëtar, niveli B1”, dhe sipas vlerësimit të gjykatës edhe në këtë rast ka evidentuar shkelje në vlerësim

Andaj, gjykata nga arsyet e cekura, e konform nenit 143 të LPK-së, e aprovoi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses dhe e anuloi pjesërisht si të kundërligjshëm konkursin e shpallur nga e paditura Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria Komunale e Arsimit me numër 17003/21 i datës 19.04.2021, për pozitën Drejtor, në Shkollën Fillore “N. F.” në Vushtri.

Për vendosjen si në pikën III të këtij dispozitivi, gjykata u bazua në nenin 463 par. 1 të LPK-së, pasi që pala nuk i ka kërkuar dhe specifikuar shpenzimet e procedurës kontestimore.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI,

Departamenti i Përgjithshëm për Çështje Civile,

C.nr.1003/2021, datë 05.10.2022

Gj y q t a r i,
Naim Rekalii

UDHEZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi, lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa ushtrohet përmes kësaj gjykate.